REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Vendim

Nr. 41 Date 22/09/ 2017

Për

Dhënien e mendimit për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC "DMH" nga subjekti " EEM INVESTIMENT " shpk , Lumi Fan I Vogël, degë e Lumit Mat, në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë.

- **Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 51 dhe nenit 52 te** ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave " Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore", nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015,"Per miratimin e rregullave dhe proçedurave të ndërtimit të kapiciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni"(i ndryshuar), me propozim te A.B.U. Mat, **Këshilli i Basenit Ujor Mat,**

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit **"EEM INVESTIMENT" shpk** me Administrator Z.Arber Habilaj , për "Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike" sipas studimit të paraqitur nga subjekti **"EEM INVESTIMENT"** shpk, me këto të dhëna:

H/C "DMH"

- Rrjedha e lumit Fan i Vogël degë e lumit Fan në Bashkinë Mirditë, Qarku Lezhë.
- Prurja mesatare **7.62 m3/sek**
- Prurja llogaritese **8.6m^3/sek**
- Prurja ekologjike **0.616m^3/sek.**
- Kuota e Vepra e marrjes: **Z- 299m.n.d** **X – 44 23 430** **Y- 46 38 720**
- Kuota e godines se HEC-i: **Z- 288 m.n.d** **X – 44 22 610** **Y- 46 37 980**
- Fuqia e instaluar : **590kw**
- Kapaciteti prodhues mesatar: **2 578 900 Kwh/vit**

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes,i furnizimit me ujë të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËSI I A.B.U. MAT
Ast NIKOLLA

KRYETARI I K.B.U. MAT
Eduard NDREÇA